

Njësia Bazë e Politikave Ekonomike dhe Turizmit, në bashkëpunim me Zyrën e Këshillimit të Karrierës dhe Alumn-it, organizuan një aktivitet social-kulturor në Muzeun "Shtëpia Kadare".

Qëllimi i këtij aktiviteti ishte:

- Të nxisë ndërgjegjësimin dhe vlerësimin e trashëgimisë kulturore shqiptare;
- Të afrojë studentët me figurat e shquara të letërsisë kombëtare;
- Të zhvillojë një qasje ndërdisiplinore ndërmjet fushave të turizmit, historisë dhe kulturës;

Aktiviteti synon të forcojë njohuritë e studentëve mbi menaxhimin e trashëgimisë kulturore si produkt turistik, si dhe t'u japë atyre një përvojë konkrete mbi atë që ofron qyteti për vizitorët vendas dhe të huaj.

Në aktivitet morën pjesë studentë të programeve Bachelor Turizëm dhe Menaxhim i Turizmit të Qëndrueshëm, si dhe pedagogët përkatës.



